

VENDIM
Nr. 577, datë 6.10.2021

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E FINANCave DHE EKONOMISË, PËR SUBVENCIONIMIN E
PAGESAVE TË QIRASË PËR FAMILJET E MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË
E FATKEQËSIVE NATYRORE, TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936/2016, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar; dhe të aktit normativ nr. 37, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në aktin normativ nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësive natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në programin e strehimit, shtohet fondi prej 800 000 000 (tetëqind milionë) lekësh, në zërin “shpenzime korrente”, përkatësisht, në produktin për pagesat e subvencionimit të qirasë për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësive natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019.

2. Efekti financiar, prej 800 000 000 (tetëqind milionë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj